


SFIDA

PËR THEMELIMIN E QENDRËS SË TRAJNIMIT PËR VENDE TË GJELBRA PUNE “GREEN JOBS TRAINING HUB”



QËLLIMI I SFIDËS




QËLLIMI I SFIDËS

Themelimi i një Qendre trajnimi për vende të gjelbra pune (“Green Jobs Training Hub”), e konceptuar si një objekt qendror e dedikuar për ofrimin e trajnimeve gjithëpërfshirëse për zhvillimin e aftësive për të rinjtë në sektorë të ndryshëm që lidhen me punët e gjelbra, si Instalues i paneleve diellore, operator i hidrocentralit, specialist i bioenergjisë, teknik i automjeteve elektrike (AE) dhe ndër të tjera, Edukator për reduktimin e mbetjeve.

Sfida po zbatohet në partneritet me Aktivitetin e USAID-it për të rinjt që aktivisht krijojnë mundësi, implementuar nga organizata Përparimi i ekonomive për komunitete më të forta (IESC) në partneritet me Forumin Arsimor Rinor dhe Qendrën për Sipërmarrësit dhe Zhvillimin e Menaxherëve.




Objektivat kryesore të Qendrës së trajnimit për vende të gjelbra pune" ("Green Jobs Training Hub")



- | **Zhvillimi i programit mësimor**
- | **Zhvillimi i aftësive**
- | **Trajnimi praktik**
- | **Relevanca e industrisë**
- | **Përafrimi, punësimi dhe mbajtja**
- | **Certifikimi**
- | **Partneritetet dhe bashkëpunimi**
- | **Rrjetëzimi dhe mentorimi**
- | **Ndërgjegjësimi mjedisor**
- | **Diversiteti dhe përfshirja**


ÇFARË PROJEKTE MBËSHTESIM



ÇFARË PROJEKTE MBËSHTESIM

Propozim projektet duhet të fokusohen në themelimin e një qendre trajnimi për vende pune të gjelbra (“Green Jobs Training Hub”), e cila do t'i pajisë individët e moshës 15 dhe 34 vjeç me aftësi thelbësore për punë të gjelbra dhe do të ofrojë udhëzime dhe mentorim të vlefshëm në karrierë për të lehtësuar integrimin e tyre në tregun e punës.

Çdo propozim duhet të mundësojë një pasqyrë të planeve për të trajnuar një minimum prej 200 individësh në një spektër të paktën dy roleve të ndryshme të punës së gjelbër gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe të lehtësojë me sukses krijimin e vendeve të punës për të paktën 25% të pjesëmarrësve.



ÇFARË PROJEKTE MBËSHTESIM

▾ OBJEKTET E TRAJNIMIT

Aplikantët kanë fleksibilitetin për të themeluar Qendrën e trajnimit për vende pune të gjelbra (“Green Jobs Training Hub”) qoftë në ambientet e tyre ekzistuese dhe të pajisura ose të përdorin metoda të ndryshme financimi për të krijuar infrastrukturën fizike të Qendrës së trajnimit për vende pune të gjelbra (“Green Jobs Training Hub”) që nga fillimi.

▾ STRATEGJIA E TRAJNIMIT

Aplikantët duhet të zhvillojnë një strategji për të tërhequr pjesëmarrësit e mundshëm përmes aktiviteteve të ndryshme të tilla si organizimi i punëtorive, webinarëve dhe aktiviteteve të angazhimit në komunitet për të demonstruar vlerën e pjesëmarrjes në Qendrën e trajnimit për vende pune të gjelbra (“Green Jobs Training Hub”), zhvillimi i fushatave të mediave sociale për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet e vendeve pune të gjelbra, etj.

▾ PROGRAMET E TRAJNIMIT

Aplikantët kanë fleksibilitetin për të zhvilluar programe trajnimi të përshtatura për lloje të ndryshme vende pune të gjelbra, dhe gjithashtu kanë mundësinë të përmirësojnë ose zgjerojnë programet ekzistuese.

▾ STRATEGJIA E PUNËSIMIT

Nga aplikantët pritet të finalizojnë një strategji për vendosjen e një rrjeti të ndërmarrjeve të sektorit privat dhe të zhvillojnë një sistem për përshtatjen e individëve të kualifikuar me mundësitë përkatëse të punësimit.

BUXHETI


Buxheti i përgjithshëm për këtë projekt është **60.000.00 USD** në kundërvlerë në denarë.

Mjetet janë siguruar në raportin e mëposhtëm:

- 40.000,00 USD nga FIZHT
- 20.000,00 USD nga Aktiviteti i USAID-it për të rinjt që aktivisht krijojnë mundësi

Përmes kësaj thirrjeje do të sigurohet financim deri në 90% të buxhetit të përgjithshëm të projektit, deri në shumën maksimale prej 60,000.00 USD kundërvlerë në denarë. Pjesa e mbetur prej 10% e buxhetit të përgjithshëm të projektit duhet të sigurohet nga aplikanti.

Kohëzgjatja e projektit duhet të jetë deri në 12 muaj.



KUSH MUND TË APLIKOJË
AKTIVITETET E PRANUESHME PËR FINANCIM
SHPENZIMET E PRANUESHME PËR FINANCIM
PROCESI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES
KRITERET E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES
MËNYRA E APLIKIMIT




KUSH MUND TË APLIKOJË

Propozim projekti mund të dorëzohet ose nga një aplikant individual ose nga një aplikant individual në partneritet dhe bashkëpunim me persona të tjerë juridikë.

Aplikantët e pranueshëm janë ndërmarrje, shoqata profesionale ose biznesi, organizata joqeveritare (OJQ), ofrues trajnimesh dhe partnerë të organizatave të mësipërme.

Të gjithë aplikantët duhet të jenë të konstituuar formalisht, të njohur dhe pa kundërshtime nga autoritetet përkatëse të Maqedonisë së Veriut, si dhe të jenë në përputhje me të gjitha rregulloret e vlefshme civile dhe fiskale.



AKTIVITETET E PRANUESHME PËR FINANCIM

- | **Formimi i Qendrës së trajnimit për vende të gjelbra pune (“Green Jobs Training Hub”)**
- | **Pagat dhe shpenzimet e fuqisë punëtore**
- | **Ekspertizë dhe shërbime konsulence**
- | **Implementimi i trajnimit**
- | **Mbështetje për zyrën dhe biznesin**

SHPENZIMET E PRANUESHME PËR FINANÇIM


Formimi i Qendrës së trajnimit për vende të gjelbra pune (“Green Jobs Training Hub”) – shpenzime për marrjen me qira të objektit të nevojshëm për Qendrën e trajnimit, shpenzime për përshtatjen e hapësirës për t’iu përshtatur programeve të trajnimit), shpenzimet për pajisjet dhe mjetet e nevojshme për programet e propozuara të trajnimit.

Ekspertiza dhe shërbimet e konsulencës – tarifatat për angazhimin e ekspertëve ose konsulentëve për të zhvilluar programe trajnimi dhe programe mësimore, kompensim për trajnerët për të kryer programe trajnimi, tarifa për konsulentët që lehtësojnë punësimin ose aktivitete të tjera të lidhura me projektin.

Pagat dhe shpenzimet e fuqisë punëtore – paga bruto në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës për personat të cilët janë ose do të punësohen nga shfrytëzuesi ose marrin pjesë drejtpërdrejt në zbatimin e projektit.

Implementimi i trajnimit – shpenzimet për aktivitetet në terren për tërheqjen e specializantëve, shpenzimet e udhëtimit për trajnerët ose specializantëve, etj.

Mbështetja e zyrës dhe biznesit – qiraja e hapësirave për zyra, shpenzimet e përgjithshme, tarifatat bankare, shërbimet e kontabilitetit, hostimi dhe llojet e tjera të shpenzimeve operative që lidhen me realizimin e projektit), në një shumë maksimale prej 15% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.




PROCESI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

- Vërtetim administrativ i dokumenteve të dorëzuara;
- Vlerësimi i parë i propozim projektit (para-përzgjedhja);
- Përzgjedhja e propozim projekteve më të mira – pas prezantimit të propozim projekteve të përzgjedhura më parë para Komisionit të vlerësimit dhe përzgjedhjes.


Çdo projekt propozim vlerësohet nga Komisioni i vlerësimit dhe përzgjedhjes, i cili përbëhet nga të paktën 5 anëtarë, duke përfshirë nga një përfaqësues prej:

- Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik;
- USAID për të rinjt që aktivisht krijojnë mundësi;
- Sektori i biznesit (ekspert në fushën për vende të gjelbra pune);
- Komuniteti akademik;
- Organizatat partnere.



KRITERET E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

- Cilësia e propozim projektit – 40 pikë
- Kapaciteti i ekipit të projektit – 20 pikë
- Ndikimi (përforcimi i zhvillimit të aftësive tek të rinjtë, rritja e punësueshmërisë së tyre, duke u mundësuar të rinjve qasje në mundësitë relevante ekonomike) – 20 pikë
- Sigurohet financim shtesë – 10 pikë
- Rrjetëzimi, promovimi dhe qëndrueshmëria – 10 pikë



MËNYRA E APLIKIMIT

- Formulari i aplikimit për projekt;
- Buxheti i projektit;
- Marrëveshje, letra bashkëpunimi dhe letra interesi për ofrimin e mbështetjes financiare/në natyrë/teknike nga ndërmarrje, donatorë, shoqata biznesi, shoqata dhe fondacione të tjera, institucione arsimore etj.;
- Në rast se ambientet e Qendrës së trajnimit për vende të gjelbra pune (“Green Jobs Training Hub”) nuk janë në pronësi të aplikantit, aplikanti duhet të dorëzojë Marrëveshje ose Letër Interesi për leje për të përdorur ambientet për kërkesat e projektit nga subjekti tjetër juridik;



Afati për dorëzimin e propozim projekteve është deri më 19.01.2024 ora 14:00.

Na kontaktoni në: greenjobshub@fitr.mk

Më shumë informacion në: www.fitr.mk

Ju falenderojme!

